

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
 ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
 GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
 FERIZAJ I UROŠEVAC

P.nr. 129/17

Më
 Dita 06. 04. 2017

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Penal gjyqtarja individuale Kadrije Goga-Lubishtani, me sekretaren juridike Florije Jakupi, në lëndën penale kundër të pandehurit [REDACTED], i akuzuar sipas Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.999-4/16, të dt.17.01.2017, për veprën penale raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 399 par. 1 nënpar. 1.5 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.999-4/16, të dt.17.01.2017 për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë, gjykata me dt.02.02.2017 mori këtë:

AKTGJYKIM

PRANOHET, kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr. 999-4/16, të dt. 17.01.2017, dhe kjo gjykatë jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

[REDACTED], nga fshati [REDACTED], i lindur me [REDACTED] në të njëjtin vend, nga i ati [REDACTED] e ëma [REDACTED], e gjinisë [REDACTED], shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal [REDACTED]

ËSHTË FAJTORË

Se me datën 10.02.2016 rreth orës 11.00 në parkingun e Viva Fresh Store në Shtime kanë konfiskuar automjetin e markës “Golf IV”, me ngjyrë hiri me targë të regjistrimit [REDACTED] dhe me numër të shasisë [REDACTED], gjatë një kontrolli dhe verifikimit të dokumentacionit dhe targave është vërtetuar se të njëjtat targa i përkasin automjetit të llojit “Kombi Volsfagen” me numër të shasisë [REDACTED] në emër të [REDACTED], është vërtetuar se i pandehuri pa autorizim ka vendosur targa në automjet dhe kjo veturë me datë 14.06.2016 i është dorëzuar doganës së Kosovës për zhdoganim,

-me të cilën ka kryer veprën penale raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 399 par. 1 nënpar. 1.5 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,41,46,73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së

G J Y K O N

Të pandehurin, me dënim me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ € në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr. 999-4/16, të dt.17.01.2017 ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR], për vepër penale raste të posaçme të falsifikimit të dokumenteve nga neni 399 par.1 nënpar. 1.5 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP/II.nr.999-4/16, të dt.17.01.2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata pasi shqyrtoj provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: fletëparaqitja penale, deklarata e të akuzuarit e dhënë në stacionin policor, vërtetimin mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve, vërtetim mbi dorëzimin e veturës në Doganën e Kosovës, gjykata vërtetoi se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqipton dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 450 dhe 451 të KPPK-së gjithashtu obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga arsyet e sipër cekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ


P.nr.129/17 datë 02.02.2017

Sekretare juridike

F. Jakupi

Gjyqtarja Individuale

Kadrije Goga-Lubishtani



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.